



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2024:207834

Datë: 13.01.2025

Numri i dokumentit: 06703128

C.nr.3253/24

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri, në çështjen juridike kontestimore të paditëses H.K.L nga Vushtrria, të cilën e përfaqësojnë Av. K.B.P dhe Av. L.P nga Vushtrria, rruga “...” p.n., kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, me objekt kontesti kompensim për orët e mësimit mbi normë, me vlerë të kontestit 1,520.75 euro, jashtë seance me datë 13.01.2025, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET E TËRHEQUR padia C.nr.3253/24 e datës 08.07.2024, e paditëses H.K.L nga Vushtrria, kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, për kompensim për orët e mësimit mbi normë, për shkak të mos pagesës së taksës gjyqësore shtesë në shumën prej 10 euro.

A r s y e t i m

Paditësja H.K.L nga Vushtrria, të cilën e përfaqësojnë Av. K.B.P dhe Av. L.P nga Vushtrria, rruga “...” p.n., pranë kësaj gjykate me datë 08.07.2024, ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, për kompensim për orët e mësimit mbi normë në shumën prej 1,520.75 euro. Me datë 04.10.2024, paditësja kishte paguar taksën gjyqësore në shumën prej 20 euro.

Me nenin 12 pika 12.1 të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, përcaktohet se *për kërkesat nga 1,001.00 euro e deri në 2,500.00 euro, duhet të paguhet taksa në shumën prej 30.00 euro.*

Me aktvendimin e datës 20.11.2024, gjykata përmes përfaqësueses së saj, e ka ftuar paditësen që në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së aktvendimit, ta bëjë pagesën e taksës gjyqësore shtesë në shumën prej 10 euro, me paralajmërimin se nëse nuk paguhet taksa shtesë, padia do të konsiderohet e tërhequr.

Përfaqësuesja e paditëses me datë 27.11.2024, e ka pranuar Aktvendimin për pagesën e taksës shtesë, por edhe pas kalimit të afatit, nuk e ka bërë pagesën e taksës shtesë.

Gjykata, në këtë rast nuk gjeti se ekzistojnë konditat për lirimin e paditësit nga pagesa e taksës gjyqësore shtesë, andaj konform nenit 253 par.5 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C.nr.3253/24, me datë 13.01.2025

Gj y q t a r i

Jeton Zymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.